

PHILIPS

Kufjet
SHC5200M2



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Udhëzime të rëndësishme sigurie	2
	Siguria për dëgjimin	2
	Informacione të përgjithshme	2
2	Kufjet tuaja Digjitale për TV	4
	Çfarë ka në kuti	4
	Përmbledhje e kufjet tuaja digjitale për TV	5
3	Fillimi	6
	Karikimi i baterisë	6
	Ndërrimi i baterisë	6
	Lidhja me pajisjen audio përmes transmetuesit	7
4	Të dhëna teknike	8
5	Njoftim	8
	Deklarata e konformitetit	8
	Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive	8
	Hegja e baterisë së brendshme	9
	Pajtueshmëria me EMF	9
	Informacione mjedisore	9
	Njoftim pajtueshmërie	9
6	Pyetje të bëra shpesh	10

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Siguria për dëgjimin



Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin në dëgjim, kufizoni kohën që e përdorni kufjet me volum të lartë dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër të jetë koha e dëgjimit.

Sigurohuni që të respektoni udhëzimet e mëposhtme kur përdorni kufjet tuaja.

- Dëgjoni me volum të arsyeshëm për periudha kohe të arsyeshme.
- Bëni kujdes të mos e ngrini vazhdimisht volumin derisa veshi juaj të përshtatet me volumin.
- Mos e ngrini volumin kaq shumë sa që të mos dëgjoni çfarë ka rreth jush.
- Duhet të bëni kujdes ose të mos e përdorni përkohësisht në situata që mund të jenë të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i tingullit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.
- Përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar gjatë drejtimit të automjetit nuk rekomandohet dhe mund të jetë i jashtëligjshëm në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni përqendrimet nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik ose në ambiente që mund të jenë të rrezikshme.

Informacione të përgjithshme

Të dhënat identifikuese ndodhet në pjesën e poshtme të pajisjes. Fisha e furnizimit kryesor shërben si pajisje shkëputëse. Priza murale duhet të instalohet pranë pajisjes dhe të jetë e qasshme lehtësisht.

Për të shmangur dëmtimet ose defektet:



Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet në nxehtësi ekstreme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria ndërrohet me një tip të gabuar.
- Mos i rrëzoni kufjet.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj spërkatjeve ose lëngjeve. (Referojuni vlerësimit IP të produktit specifik)
- Mos lejoni që kufjet të zhyten në ujë.
- Mos kryeni karikimin e kufjeve të kokës kur konektori ose priza janë të lagura.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, benzen ose gërryes.
- Përdorni një leckë të pastër dhe të lagësht për të pastruar kufjet tuaja – me vëmendje të veçantë për kanalet zanore dhe vrimat e mikrofonit – të cilat duhet të pastrohen rregullisht dhe shmangni grumbullimin e substancave të tilla si djersa ose dylli i veshit.
- Nëse ka mbetje të ndonjë pike djersë ose uji në kanalet zanore, vrimat e ajrit ose vrimat e mikrofonit, niveli i zërit do të pësojë rënie të përkohëshme ose nuk do të ketë zë fare. Ky nuk është një defekt. Përdorni një leckë të butë dhe të njomë për të tharë plotësisht kufjet. Në të kundërt, hiqni veshjet e kufjeve, ktheni kanalet zanore me drejtim nga poshtë dhe prekni lehtë kufjet rreth pesë herë në një leckë të thatë ose dicka të ngjashme për të larguar çdo ujë të mbledhur brenda.
- Sigurohuni që kufjet e kokës të jenë plotësisht të thata përpara se t'i vini në karikim dhe përdorim. Shmangni përdorimin e tamponëve të alkoolit njëpërdorimësh ose substancave të tjera për pastrim.
- Bateria e brendshme nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësive të tepërta si për shembull drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërroni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.

- Për të kapur vlerësimin specifik IP, kapaku i folesë së karikimit duhet të mbyllet.
- Asgjësimi i një baterie në zjarr ose në një furrë të nxehtë, ose shtypja apo prerja mekanike e një baterie, mund të bëhet shkak për shpërthim.
- Lënia e një baterie në një ambient rrethues me temperaturë jashtëzakonisht të lartë mund të bëhet shkak për një shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të djegshëm.
- Një bateri që i nënshtrohet trysisë jashtëzakonisht të ulët të ajrit, kjo mund të bëhet shkak për një shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të djegshëm.
- Zëvendësimi i një baterie me një lloj tjetër që nuk është e duhura, rrezikon të dëmtojë rëndë kufjet e kokës dhe baterinë (për shembull, në rastin kur bëhet fjalë për disa lloje të baterive me litium).
- Kur kufjet nuk përdoren për një kohë të gjatë, bateria e ringarkueshme do të fillojë të humbasë ngarkesën e saj. Për të shmangur këtë humbje, jeni të lutur të karikoni plotësisht baterinë të paktën një herë në tre muaj.
- Për të shmangur rrezikun e zjarrit, pajisja furnizohet vetëm nga burimi i jashtëm i energjisë, prodhimi i të cilit duhet të jetë në përputhje me standardin P51 (me kapacitet dalës më të vogël se 15 W).

Temperaturat e ruajtjes dhe funksionimit dhe lagështia

- Mbajeni në një vend ku temperatura është ndërmjet -20 °C (-4 °F) dhe 50 °C (122 °F) me lagështi relative deri në 90 %.
- Vëreni në përdorim në një vend ku temperatura është ndërmjet 0 °C (32 °F) dhe 45 °C (113 °F) me lagështi relative deri në 90 %.
- Jetëgjatësia e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte temperature të lartë ose të ulët.



Paralajmërim

- Ndalohet asgjësimi i baterisë në zjarr ose në furrë të mbinxehur, si dhe shtypja apo prerja mekanike e saj.
- Mos e lini baterinë në një ambient rrethues me temperaturë jashtëzakonisht të lartë.
- Për të shmangur dëmtimet, mos ekspozoni baterinë në presion atmosferik tepër të ulët.



Simboli tregon tension DC



Simboli tregon pajisje të klasës II



Simboli tregon tension AC



Përdorim vetëm për ambiente të brendshme



RICIKLIMI

- Ky produkt mban simbolin e ndarjes selektive për mbetje elektrike dhe elektronike (WEEE). Kjo do të thotë se ky produkt duhet trajtuar në përputhje me Direktivën Evropiane 2012/19/EU, në mënyrë që të riciklohet ose të çmontohet për të minimizuar ndikimin e tij mbi mjedisin.
- Përdoruesi ka të drejtën ta dorëzojë produktin tek një organizatë e licencuar riciklimi ose tek shitësi, në momentin që blen një pajisje të re elektrike ose elektronike.

2 Kufjet tuaja Digjitale për TV


Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin tuaj në www.philips.com/support. Me këto kufje digjitale për TV Philips ju mund të:

- Shijoni shfaqje televizive pa tela me lehtësi;
- Shijoni dhe kontrolloni muzikën pa tela.


Çfarë ka në kuti




Kufje Digjitale për TV Philips SHC5200M2



Transmetues



Adaptues AC/DC



Udhëzues për fillimin e shpejtë





Garancia botërore



Fletëpalosja për sigurinë

Përmbledhje e kufjet tuaja digjitale për TV



- ① Ndezja/fikja
- ② Rregullatori i volumit
- ③ Buton rrëshqitës i kapakut të baterisë
- ④ Portë karikimi Tipi-C (në kufje)
- ⑤ Treguesi LED
- ⑥ Portë karikimi Tipi-C (në transmetues)
- ⑦ Xheku i audios 3,5 mm

3 Fillimi


Karikimi i baterisë

Shënim

- Para se t'i përdorni kufjet tuaja, karikoni baterinë për 3 orë me qëllim që bateria të ketë kapacitet dhe jetëgjatësi optimale.
- Përdorni vetëm adaptuesin original AC/DC për të shmangur dëmtimet.
- Kur kufjet nuk përdoren për një kohë të gjatë, bateria e ringarkueshme do të fillojë të humbasë ngarkesën e saj. Për të shmangur këtë humbje, jeni të lutur të karikoni plotësisht baterinë të paktën një herë në tre muaj.

Futni një skaj të adaptuesit AC/DC në kufje dhe skajin tjetër në burimin e energjisë.

- ↳ Gjatë karikimit, treguesi LED bëhet jeshil dhe fiket kur kufjet janë plotësisht të karikuara.




Këshillë

- Normalisht, karikimi i plotë zgjat 3 orë.


Ndërrimi i baterisë

- 1 Shtyni butonin rrëshqitës të kapakut të baterisë për ta hapur.
- 2 Hiqni baterinë dhe zëvendësojeni me një të re.



Lidhja me pajisjen audio përmes transmetuesit

- 1 Mbajeni të shtypur butonin e NDEZJES/FIKJES të kufjes për 2 sekonda për ta aktivizuar; LED-i i kuq do të pulsojë.
- 2 Lidhni transmetuesin me energjinë elektrike përmes adaptuesit AC/DC; treguesi LED i energjisë do të pulsojë i kuq.
- 3 Lidhni pajisjen audio me transmetuesin përmes prizës audio 3,5 mm; treguesi LED i sinjalit do të pulsojë me ngjyrë jeshile.



4 Të dhëna teknike

- Koha e riprodhimit: 30 orë
- Koha e karikimit: 3 orë
- Bateria: Bateri e karikueshme me polimere litiumi (3,7 V 600 mAh)
- Adaptues: YLJXB-E050055
hyrja: 100-240 Vac, 50/60 Hz, 0,5 A maks
dalja: 5 Vdc, 0,55 A, 2,75 W
- Gama e frekuencës: 2,4-2,4835 GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 20 dBm
- Gama e operimit: Deri në 30 metra (98 këmbë)
- Porta USB-C për karikim
- Ndërprerës hyrjeje 3,5 mm
- Teknologji komunikimi RF 2,4 G
- Karikim i shpejtë: 15 minuta karikim sigurojnë rreth 4 orë riprodhim



Shënim

- Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar.
- Jetëgjatësia e baterisë e kohës së lojës është e përafërt dhe mund të ndryshojë në varësi të kushteve të aplikimit.

5 Njoftim

Deklarata e konformitetit

Nëpërmjet këtij dokumenti, TP Vision Europe B.V. deklaron se produkti është në përputhje me kërkesat thelbësore dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës RED 2014/53/EU dhe Rregullores SI 2017 No 1206 të Pajisjeve Radio të MB. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.

Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është bërë dhe është prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.




Ky simbol nënkupton se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane (EU) 2023/1542 të cilat nuk mund të asgjësohen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqui rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterisë së brendshme

Nëse në vendin tuaj nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produktet elektronike, mund ta mbron mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë para se t'i hidhni kufjet.

- Sigurohuni që kufjet e kokës të jenë shkëputur përpara se të hiqni baterinë.



Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt i përmbahet të gjitha standardeve dhe rregullave lidhur me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Sistemi juaj përbëhet nga materiale që mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Lutemi, respektoni rregulloret lokale në lidhje me asgjësimin e materialeve të paketimit, baterive të harxhuara dhe pajisjeve të vjetra.

Njoftim pajtueshmërie

Pajisja i përmbahet rregullave FCC, pjesa 15. Operimi është subjekt i dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojë operim të padëshiruar.

6 Pyetje të bëra shpesh

Kufjet e mia digjitale për TV nuk ndizen.

Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni përmes adaptuesit AC/DC për 3 orë.

Pse kufjet e mia nuk lidhen me TV?

Kufjet përdorin teknologjinë valore 2,4 GHz me rreze maksimale deri në 30 metra (98 këmbë). Defektet e lidhjes ndodhin kur:

- Distanca tejkalohe - Lëvizni më afër transmetuesit (brenda 30 m)
- Pengesa të pranishme - Hiqni muret/ objektet metalike mes transmetuesit dhe kufjeve
- Burime ndërhyrjeje - Fikni ruterat Wi-Fi, mikrovalët ose pajisjet Bluetooth aty pranë

Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohet zhurmë kërcitjeje.

- Kontrolloni integritetin e kabllit: Tela të përkulur ose të shqyer shkaktojnë ndërhyrje.
- Pastroni portën audio: Pluhuri në portën e TV-së ose të kufjeve ndërpret lidhjen. Përdorni ajër të kompresuar për pastrim.
- Rregulloni rrotën e volumnit: Tejkalimi i volumnit shkakton shtrembërim tingulli. Mbajeni rrotulluesin e volumnit nën 80% të nivelit maksimal.

Nuk ka asnjë tingull nga njëra kupë e kufjes.

- Ndërroni kanalet audio: Testoni ekuilibrin majtas/djathtas në cilësimet e TV-së.
- Kontrolloni simetrinë e kabllit: Fishat e futura pjesërisht japin vetëm audio mono. Ripërsëritni lidhjen fort.

- Kontrolloni ventilimin/vrimat e kupës së kufjes: Bllokimi i rrjedhës së ajrit e zbeh zhurmën/tingullin. Pastroni rrjetëzën me një furçë të butë.

Pastroni rregullisht kufjet.

- Përdorni një leckë të pastër dhe të lagësht për të pastruar kufjet tuaja – me vëmendje të veçantë për kanalet zanore dhe vrimat e mikrofonit – të cilat duhet të pastrohen rregullisht dhe shmangni grumbullimin e substancave të tilla si djersa ose dylli i veshit.
- Nëse ka mbetje të ndonjë pike djerse ose uji në kanalet zanore, vrimat e ajrit ose vrimat e mikrofonit, niveli i zërit do të pësojë rënie të përkohëshme ose nuk do të ketë zë fare. Ky nuk është një defekt. Përdorni një leckë të butë dhe të njomë për të tharë plotësisht kufjet. Si alternativë, për futjen në vesh, hiqni majat e kufjeve, rrotulloni kanalet e zërit poshtë dhe prekni butësisht kufjet rreth pesë herë në një leckë të thatë ose diçka të ngjashme për të hequr çdo ujë të mbledhur brenda.
- Sigurohuni që kufjet e kokës të jenë plotësisht të thata përpara se t'i vini në karikim dhe përdorim. Shmangni përdorimin e tamponëve të alkoolit njëpërdorimësh ose substancave të tjera për pastrim.

Karikoni rregullisht kufjet tuaja.

Kur kufjet nuk përdoren për një kohë të gjatë, bateria e ringarkueshme do të fillojë të humbasë ngarkesën e saj. Për të shmangur këtë humbje, jeni të lutur të karikoni plotësisht baterinë të paktën një herë në tre muaj.

Për ndihmë të mëtejshme, vizitoni www.philips.com/support.



2025 © MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar. Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt. Të gjitha emrat e kompanive dhe produkteve të tjera mund të jenë marka tregtare të kompanive të tyre përkatëse me të cilat kanë lidhje.

UM_SHC5200M2_12_SQ_V1.0

